

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Eroll Gashi, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.D., nga Hani i Elezit, për shkak të veprës penale - lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1, nën par. 1.3 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e të akuzuarit H.D., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.87/17 të datës 04.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.06.2018 morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit H.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore, PKR.nr.87/17 i dt. 04.08.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.87/17 të dt. 04.08.2017, i akuzuari H.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale- lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1, nën par 1.3 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgimi në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve, të cilin dënim i akuzuari do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.06.2017 deri me datën 04.08.2017. I dëmtuari I.B. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30(tridhjetë) € dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20(njzet) €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i akuzuari H.D., për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose i njëjti të ndryshohet në kuptim të pretendimeve ankimore.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I nr. 208/18 të dt. 10.05.2018, ka propozuar të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit H.D. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ishte i pranishëm i akuzuari H.D., ndërsa munguan Prokurori i Apelit, mbrojtësia e të akuzuarit av. M.K. si dhe i dëmtuari I.B. edhe pse ishin të njoftuar me rregull, andaj seanca e kolegjit u mbajti në mungesë të tyre konform nenit 390 par. 4 të KPPK. Në seancën e kolegjit i akuzuari H.D. mbeti në tërësi pranë ankesës së parashtruar.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi të pretendimet e theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje tjera të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par. 2 të KPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimit ankimor.

Përkritazi me vendimin për dënimin i akuzuari H.D., në ankesë thekson se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar është i lartë sepse i akuzuari në gjitha fazat e hetimit dhe në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës dhe ka shprehur pendimin e tij të thellë duke i kërkuar falje të dëmtuarit I.B., para trupit gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pasur sjellje të mira, është i moshës së re, gjendja e rëndë ekonomike dhe se i njëjti asnjëherë me parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, andaj pretendon se ky dënim është i paarsyeshëm dhe mjaft i lartë.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese konform nenit 73 të KPRK, duke vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar: pendimin e shprehur nga i akuzuari për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, kërkim faljen publike ndaj të dëmtuarit në shqyrtimin fillestar, faktin se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe nuk kanë më asgjë të keqe, gjendjen e varfër ekonomike, moshën e re, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallës e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe mbi bazën e rrethanave të tilla, gjykata konform nenit 75 par.1, nën par. 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së aplikoi institutin e zbutjes së dënimit dhe të njëjtit i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve me bindjen se në rastin konkret edhe përmes këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që të parandaloj kryesin dhe personat e tjerë që në të ardhmen të kryejnë vepra penale, duke konsideruar se ky dënim është adekuat dhe në proporcion me peshën konkrete të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin në pajtim me pretendimet ankimore Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore për një dënim më të butë nuk janë të bazuara.

Në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, baza fillestare për matjen e dënimit, kryesit të veprës së caktuar penale, paraqet kufirin ligjor të dënimit të paraparë për atë vepër, ku gjykata ka autorizime diskrecionale që nën kushtet e parashikuara nga neni 74 , 75 dhe 76 të KPRK-së që të devijoj nga orientimi i tillë, por vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara sipas këtyre dispozitave.

Vlerësimin e rrethanave për matjen e dënimit nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendim të thellë, ka pasur sjellje të mira gjatë shqyrtimit gjyqësor, është i një moshe të re, i njëjti nuk ka rënë asnjëherë më parë ndesh me ligjin, është i gjendjes së dobët ekonomike, si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë dhe konsideron se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim në përputhje me rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar dhe se dënimi i shqiptuar nga kjo gjykatë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale e duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme si dhe asaj të posaçme dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së. Për këto arsye, ankesa e të akuzuarit që ti shqiptohet një dënim më i butë, është refuzuar si e pa bazuar aq më tepër kur akuzuari në fjalë në ankesë nuk ka paraqitur asnjë rrethanë tjetër të cilat nuk janë vlerësuar apo nuk janë marrë për bazë nga gjykata e shkallës së parë e të cilat do ti mbështesnin pretendimet në ankesë.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 221/2018 datë 14.06.2018

Procesmbajtës,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi
